



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit të Komunës



Në vështrim të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), të Udhëzimit Administrativ të MAPL - së nr. 2008/08 për Marrëveshjet e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe të nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 21.12.2012 miratojë:

R R E G U L L O R E N
PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT,
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DRENASIT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Në bazë të kësaj Rregulloreje, rregullohet organizimi dhe bashkëpunimi në mes të Komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Drenasit, zgjedhja e këshillave, kompetencat dhe përgjegjësitë e këshillave, duke i siguruar qytetarët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre në shumë fusha të jetës dhe paraqitje të organizuar para Komunës dhe organeve të saj, që realizohet në pajtim me Statutin e Komunës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe akte tjera ligjore.

Konstituimi (themelimi) i këshillave të lokalitetit

Neni 2

2.1. Në Komunën e Drenasit, vetëqeverisja lokale ushtrohet në nivel të bashkësive lokale. Në qytet, bashkësi urbane dhe në fshatra - vendbanime, bashkësi rurale.

f.1

2.2 Territori për të cilën themelohen bashkësitë urbane, janë kufijtë e bashkësive urbane sipas planit urbanistik të qytetit. Bashkësitë lokale mbulojnë territorin brenda kufijve të fshatrave, sipas kadastrës së vendbanimeve.

2.3 Në pamundësi që në çdo fshat, vendbanim ose lagje urbane të zgjedhen këshillat, atëherë një këshill mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.

Neni 3

Këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane do të kenë nga 5 - 7 anëtarë, Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill, në bazë të kësaj Rregulloreje, përcaktohet me vendim të Kuvendit të Komunës.

Në rast se këshilli zgjedhet për më shumë fshatra, vendbanime apo lagje urbane, atëherë përbërja e këshillit duhet të reflektojë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje urbane, përfaqësimin gjinor dhe etnik.

Në rast se në një fshat, vendbanime apo lagje urbane jetojnë anëtarë të pakicave, ata duhet të jenë të përfaqësuar në këshill, së paku me një (1) anëtar.

Këshilli i fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve zgjidhet në tubimet e qytetarëve, përmes votimit të fshehtë apo të hapur, në këtë këshill duhet të përfaqësohen edhe etnitetet politike që veprojnë në fshatë.

Tubimin publik e hap qytetari më i moshuar, i cili merr pjesë në tubim dhe kryeson me tubimin deri në zgjedhjen e këshillit.

Këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane zgjedhen me mandat 4-vjeçar dhe nga radhët e anëtarëve të tij zgjedhet kryetari, me mandat 4-vjeçar. Deri te zgjedhja e kryetarit të këshillit, me këshill udhëheq anëtari më i moshuar i atij këshilli.

Kryetari i këshillit zgjidhet kandidati, i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane të pranishëm në mbledhje. Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët për kryetar të këshillit nuk ka fituar numrin e duhur të votave, atëherë organizohet rrethi i dytë i votimit për dy kandidatë, të cilët kanë fituar numër më të madh të votave.

Këshilli, anëtarët dhe kryetari, mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit, nëse nga zgjedhësit e tyre konstatohet se nuk kanë kryer obligimet që dalin nga kjo Rregullore dhe legjislacioni i zbatueshëm. Shkarkimi i këshillit dhe i kryetarit të këshillit, bëhet sipas procedurës së njëjtë për zgjedhjen e këshillit dhe të kryetarit.

Neni 4

Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Komisioni duhet të përfshijë anëtarë të spektrit politik, etnik dhe gjinor të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës dhe profesionistë ligjorë.

Komisioni emërohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Dy javë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave, Kuvendi i Komunës, përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun, përveç tjerash, informon qytetarët edhe përmes:

- a. shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- b. medieve lokale të shkruara dhe elektronike dhe
- c. ueb -faqes zyrtare të Komunës.

Njoftimi i publikut, sipas paragrafit 6.1 të kësaj Rregulloreje, gjithsesi duhet të përmbajë:

- a) datën e tubimit të qytetarëve;
- b) kohën e tubimit të qytetarëve;
- c) vendin e mbajtjes së tubimit të qytetarëve dhe
- d) rendin e ditës.

Neni 6

Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përmbajë: numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e këshillit lokal, procedurat e votimit dhe çështje tjera të nevojshme që duhet të shënohen në procesverbal.

Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje, i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e këshillit

Neni 7

Këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:

- a) Hartojnë dhe miratojnë Rregulloren e punës së këshillit;
- b) Organizojnë, përcjellin dhe planifikojnë zhvillimet e lokalitetit, në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Komitetet, Kryetarin e Komunës dhe Drejtoritë e Administratës së Komunës;
- c) Emërojnë komisionet përkatëse për t'i realizuar objektivat e fshatit, vendbanimit dhe lagjes;
- d) Evidencojnë dhe paraqesin prioritetet e lokalitetit para organeve të Komunës;
- e) Hartojnë planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat;
- f) Ndërmarrin iniciativë për ruajtjen e objekteve në pronësi të Komunës dhe në pronësi shtetërore, dhe pasurive tjera të paluajtshme shtetërore në lokalitetin përkatës;
- g) Bëjnë llogarinë 6-mujore dhe vjetore të mjeteve të arkëtuara dhe i bën ato transparente për qytetarët e lokalitetit, në harmoni me dispozitat e Statutit të Komunës dhe të kësaj Rregulloreje;
- h) Sigurojnë të dhënat elementare për secilën familje të lokalitetit përkatës, përcjellin gjendjen ekonomike të tyre dhe japin rekomandime e propozime në lidhje me këto;

- i) Caktojnë persona përgjegjës, të cilët ngarkohen me faturat për përcjelljen e gjendjes finaciare të lokalitetit, sipas kategorive të cilat caktohen me vendim të posaqëm të këshillit të lokalitetit;
- j) Kujdesen për organizimin e aksioneve vullnetare në interes të lokalitetit;
- k) Kujdesen për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
- l) Kujdesen për sigurimin e hapësirave dhe varrezave;
- ll) Kujdesen për furnizim me ujë, rregullimin e kanalizimit, infrastrukturës lokale, drenazhimet dhe ofrimin e shërbimeve publike efikase në lokalitet etj.;
- m) Kujdesen për ofrimin e mbrojtjes parësore shëndetësore të qytetarëve të lokalitetit;
- n) Kujdesen për mbrojtjen e ambientit të lokalitetit;
- nj) Kujdesen për kushtet e zhvillimit të procesit arsimor në lokalitet;
- o) Kujdesen për zhvillimin e turizmit;
- p) Nxjerrin vendime dhe rekomandime në interes të qytetarëve të lokaliteteve në komunë, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm;
- q) Kryejnë edhe detyra të tjera, të cilat mund të jenë të bartura nga Kuvendi i Komunës ose Kryetari i Komunës, në pajtim me ligjin dhe Statutin e Komunës.

Neni 8

Në bazë të nevojave dhe kërkesës së qytetarëve, apo me iniciativën e Këshillit, mund të përcaktohet grumbullimi i vetëkontributit të qytetarëve, në pajtueshmëri me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë. Vendimin e merr Këshilli.

Neni 9

Ndërprerja dhe heqja e mandatit të anëtarëve dhe kryetarit të këshillit lokal

1.Në rastet kur qytetarët konstatojnë së anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal nuk i përmbushin obligimet e veta të cilat rrjedhin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicën e votave të banorëve prezentë të fshatit, vendbanimit apo lagjeve urbane gjatë mbledhjes publike me qytetarët.

2.Për të ndodhur ky votim, duhet të ekzistojë një peticion për ndërprerjen e mandatit, i cili duhet të jetë i nënshkruar nga ana e qytetarëve të fshatit, vendbanimit apo lagjeve urbane. Ky peticion duhet t'i sigurojë nënshkrimet e më shumë së gjysmës të pjesëmarrësve në mbledhje ku është zgjedhur këshilli lokal. Komuna duhet të informohet më parë për një mbledhje të tillë.

3.Në rastet kur këshilli lokal është shkarkuar në vështrim të udhëzimeve të paragrafit 2, një votim i ri duhet të kryhet menjëherë në bazë të dispozitave të nenit 3 të kësaj Rregullore me qëllim të zgjedhjes së këshillit lokal të ri. Rezultatet e votimit duhet të publikohen në vështrim të kësaj Rregullore.

4.Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Këshillave lokale përfundon:

- 4.1. me përfundimin e mandatit,
- 4.2. nëse vdes,
- 4.3 .nëse paraqet dorëheqje,
- 4.4. nëse ndërrohet vendbanimin,
- 4.4 .nëse shkarkohet.

f.4

Përgjegjësitë e bartura nga Komuna në këshill

Neni 10

Me kërkesën e Këshillit dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim, mund t'i bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat e fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane.
Komuna ofron burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur.

Bashkëpunimi i organeve të Administratës së Komunës me këshillat e lokaliteteve

Neni 11

Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Drenasit, me pëlqimin e tyre, mund të organizohen dhe bashkëpunojnë në mes veti për ushtrimin e aktiviteteve të përbashkëta të bartura nga Komuna. Vendimin për bashkëpunimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane e miraton Kuvendi i Komunës, në bazë të kërkesës së tyre.

Mospërmbushja e përgjegjësisë

Neni 12

Për të gjitha punët e bartura në këshill nga Kuvendi i Komunës, këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane përkatëse, mban obligime dhe përgjegjësi ligjore në rast të keqpërdorimit eventual. Përgjegjësia para qytetarëve dhe organeve përkatëse, mund të jetë individuale apo kolektive.

Neni 13

Detyrat e Kryetarit të këshillit lokal

1. Kryetari i Këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në konsultim dhe diskutim me organet e komunës.
2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq mbledhjen e këshillit dhe është i detyruar për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Poashtu ai nënshkruan rekomandimet dhe propozimet të cilat janë miratuar nga ana e këshillit lokal dhe obligohet që në afatin prej 15 ditësh nga data e miratimit t'ia dorëzojë Kryetarit të Komunës.

Neni 14

Finansimi i aktiviteteve

1. Finansimi i aktiviteteve të Këshillave lokale mund të bëhet edhe nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjeve urbane, komunës, finansimi i përbashkët përmes donacioneve, por çdo herë konform Statutit, urdhëresave të komunës dhe ligjeve për menaxhimin e financave publike që aplikohen në Republikën e Kosovës.

2. Këshilli lokal përgatit raportin gjashtëmujor dhe vjetor të mjeteve të hyra dhe ato të shpenzuara të cilat duhet të jenë transparente karshi qytetarëve të lokalitetit dhe para organeve të komunës.

Neni 15

Kompenzimi i këshillave komunale

Kompenzimi i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane do të rregullohet nga ana e Kuvendit të Komunës me një vendim të vecantë.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 16

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj Rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës, mbizotrojnë dispozitat e Ligjit dhe Statutit.


Neni 17

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore, do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së saj.

Neni 18

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e organit kompetent dhe tetë ditë pas informimit të publikut në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e komunës.

2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, komuna është e obliguar në afatin prej gjashtë muajsh të fillojë me zbatimin e kësaj Rregullore.

Kryesusi i Kuvendit

Naim Bazaj



f.6